

# Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete

2022  
janar-dhjetor

Emërimi i Zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete (ZKXXX) është i detyrueshëm kur komunitetet përbëjnë së paku dhjetë për qind të banorëve të komunës. Mandati i ZKXXX-së është të shqyrtojë ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve për shkeljet e të drejtave të tyre përmes akteve apo vendimeve të Kuvendit Komunal (KK) dhe është përgjegjës për parashtrimin e ankesave të tilla në Kuvend. ZKXXX-ja mund të kërkojë rishikimin e aktit apo vendimit në fjalë. Gjithashtu, siç parashihet me dispozita ligjore, në rrethana specifike, ZKXXX-ja mund t'i parashtrorë Gjykatës Kushtetuese aktet apo vendimet që konsiderohen se shkelin të drejtat e garantuara me kushtetutë. Në komunat ku komunitetet joshumicë e kalojnë pragun prej dhjetë për qind, kjo pozitë i rezervohet përfaqësuesit të komunitetit joshumicë që ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin Komunal.

## Dokumentet kryesore

- Kushtetuta, neni 62 (1) dhe (2);
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Nr.03/L-040, 2008);
- Udhëzuesi për Zëvendëskryesuesin e Kuvendit Komunal për Komunitete.

## Themelimi

ZKXXX-të janë caktuar në 13 komuna.

### Pozita të themeluara për ZKXXX\*

|                                 |                          |
|---------------------------------|--------------------------|
| Dragash                         | Novobërdë                |
| Fushë Kosovë                    | Pejë                     |
| Graçanicë                       | Prizren                  |
| Istog                           | Shtërpçë                 |
| Klokot/Kllokot                  | Zubin Potok <sup>1</sup> |
| Mamushë                         | Zveçan <sup>1</sup>      |
| Mitrovicë e veriut <sup>1</sup> |                          |


<sup>1</sup> Mungesa e të dhënave zyrtare të regjistrimit për këto komuna krijon paqartësi në lidhje me themelimin e pozitës. Prandaj, për qëllimet e kësaj analize, janë përdorur përlogaritjet e popullsisë në profilet komunale të Misionit të OSBE-së në Kosovë, për vitin 2018. (Gjenden tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>)

\* **Me bold** theksohen vendet ku ZKXXX-të janë obligativë sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë.

Janë caktuar të gjithë ZKXXX-të obligativë.


## Qasja në burime financiare \*

\*Sipas vlerësimit të ZKXXX-ve




## Përfaqësimi i komuniteteve dhe gjinive

### Përfaqësimi i komuniteteve



### Përfaqësimi gjinor



\*Një grua (shqiptare e Kosovës) është emëruar si ZKXXX vetëm në komunën e Zveçanit.

# Performanca në vitin 2022


## Treguesit e përzgjedhur të performancës

Numri i ZKKKK-ve që ndërmorën aktivitete kyçe dhe kryen detyra thelbësore të përshkruara në kornizën ligjore dhe të politikave. Informatat e bazuara tek monitorimi i rregullt të ekipeve në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe shqyrtimet periodike specifike, si dhe në raportet e zhvilluara nga komunat, që mbulojnë vitet 2020-2022.

Shënim: të dhënat e vitit 2021 mbulojnë periudhën para zgjedhjeve komunale, përkatësisht nga janari deri në tetor 2021.

### 1 – Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve


Shqyrtimi i pretendimeve për akte apo vendime të KK-së për shkelje të të drejtave të komuniteteve



Gjatë periudhës raportuese, vetëm një pretendim për shkelje të të drejtave të komuniteteve nga Kuvendi Komunal është dorëzuar në ZKKKK. ZKKKK në Mitrovicë Veriore e ka shqyrtuar kërkesën. Megjithatë, kjo çështje nuk është shqyrtuar/zgjidhur nga KK.


### 2 – Promovimi i dialogut ndërkomunitar

Angazhimi në aktivitete për promovimin e dialogut ndërkomunitar




### 3 – Raportimi

Ofrimi i informatave lidhur me aktivitetet dhe punën e saj tek organet tjera komunale




### 4 – Bashkëpunimi

Pjesëmarrja në mbledhje të Komitetit për Komunitete




Bashkëpunimi në shqyrtimin e politikave komunale që prekin interesat e komuniteteve



### 5 – Kontaktimi dhe konsultimet

Lehtësimi i angazhimit të komuniteteve në punën e Kuvendit Komunal



■ 2022 ■ 2021 ■ 2020

## Performanca e përgjithshme

Rezultatet e performancës së ZKKKK-ve bazohen në rezultatet e përmbledhura të treguesve të performancës, të cilët pasqyrojnë aktivitetet kryesore dhe detyrat thelbësore të parapara me kornizën ligjore dhe të politikave përkatëse. Performanca vlerësohet "e lartë" kur rezultati i mbledhur është mbi 66 për qind, "mesatare" kur luhet midis 66 për qind dhe 33 për qind, si dhe "e ulët" kur është nën 33 për qind.

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet pjesëmarrjen e rritur të komuniteteve në proceset dhe institucionet e vendimmarrjes dhe qeverisjes publike. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, Misioni i OSBE-së në Kosovë monitoron rregullisht performancën e mekanizmave mbrojtës të komuniteteve komunale. Këto fletë informuese synojnë t'u ofrojnë institucioneve përkatëse tregues që mund të ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.

|                                  | Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve | Bashkëpunimi | Raportimi  | Kontaktimi dhe konsultimet | PERFORMANCA E GJITHMBASHMJE |
|----------------------------------|--|--------------|------------|----------------------------|-----------------------------|
| Dragash                          | Mesatare                                   | E ulët       | E ulët     | E lartë                    | 39%                         |
| Fushë Kosovë                     | E lartë                                    | E lartë      | E ulët     | E lartë                    | 64%                         |
| Graçanicë                        | E ulët                                     | E ulët       | Mesatare   | E ulët                     | 16%                         |
| Istog                            | E ulët                                     | E lartë      | Mesatare   | E ulët                     | 38%                         |
| Kllokot                          | E ulët                                     | Mesatare     | Mesatare   | E lartë                    | 41%                         |
| Mamushë                          | E ulët                                     | Mesatare     | E ulët     | E ulët                     | 9%                          |
| Mitrovicë Veriore                | E lartë                                    | E lartë      | Mesatare   | E ulët                     | 58%                         |
| Novobërdë                        | E ulët                                     | Mesatare     | E lartë    | E ulët                     | 28%                         |
| Pejë                             | E lartë                                    | E lartë      | Mesatare   | E lartë                    | 82%                         |
| Prizren                          | E ulët                                     | E ulët       | E ulët     | E ulët                     |                             |
| Shtërpcë                         | E ulët                                     | E ulët       | Mesatare   | E lartë                    | 42%                         |
| Zubin Potok                      | E ulët                                     | Mesatare     | E ulët     | E ulët                     | 9%                          |
| Zveçan                           | E ulët                                     | E lartë      | Mesatare   | E ulët                     | 33%                         |
| <b>PERFORMANÇË MESATARE 2022</b> | <b>27%</b>                                 | <b>52%</b>   | <b>34%</b> | <b>31%</b>                 | <b>35%</b>                  |